

SHABAN DEMIRAJ

KUPTIMET KRYESORE TË KOHËVE TË MËNYRËS DËFTORE NË GJUHËN SHQIPE

§ 1. Koha e tashme

Kuptimi themelor i kohës së tashme të mënyrës dëftore është të tregojë kryerjen e një veprimi¹ në një kohë, që përfshin edhe çastin e ligjërit. Por, siç do të shtjellohet edhe më poshtë, në gjuhën shqipe ajo përdoret edhe me një kuptim kohor të pacaktuar e në disa rrethana edhe me kuptimin e së ardhmës dhe të së shkuarës.

Kur përdoren në kuptimin themelor të kohës së tashme, foljet (me disa përjashtime për të cilat shih më poshtë shënimet 1,2) shoqërohen rregullisht me pjesëzën *po*. Kjo i jep mundësi foljes në kohën e tashme të tregojë një veprim të veçuar, që vazhdon ende në çastin e ligjërit. Pra, e shoqëruar me pjesëzën *po*, folja në kohën e tashme të dëftores shpreh një veprim të veçuar me aspekt vazhdimësie. Po me këtë kuptim mund të përdoret edhe forma perifrastike e ndërtuar me anë të kohës së tashme të ndihmësës *jam* dhe përcjellores së foljes themelore. P.sh.

... Ja, *po hesht*. Vetëm ti m'u hiq sysh... (Dh. Xhuvani, Përsëri në këmbë, 17).

— Ç'po bën këtu? — e pyeti kryeveqilharxhi kur kaloi përbri.

— *Po vështroj* si mblidhet këshilli i lavdishëm - tha kronikani. (I. Kadare, Kështjella, 16).

... Pak më parë më thanë se *je duke bërë* këmbë për veten tënde. (Dh. Xhuvani, Përsëri në këmbë, 99). Ju do të thoni se *jam duke treguar* edhe një tjetër «histori të jashtëzakonshme», duke dashur të më thoni, ndofta, që *po bëhem* monoton. (Dh. Shuteriqi, Kënga dhe pushka, 221).

Shënime:

1) Disa folje, që emërtojnë veprime ose gjendje, që e karakterizojnë kryefjalën për një kohë të pacaktuar, nuk shoqërohen me pjesëzën *po*. Të tilla janë foljet *dua*, *di*, *dashuroj*, *urrej*, *zotëroj*, *kam*, *jam*, *gjendem*, *nxë*, *përmban*, *ngërthen* etj. P.sh.

Dhe tani *s'dua* të më shqetësojë njeri. (Kadare, Kështjella, 10)
— Ju *admiroj!* Nuk do ta harroj kurrë këtë mbrëmje, që po kalojmë

1) Termi *veprim* këtu dhe në paragrafët, që ndjekin, është përdorur në një kuptim të gjerë duke përfshirë edhe kuptimin e foljeve që tregojnë gjendje ose ndryshim në gjendjen e kryefjalës.

me ju. (Dh. Shuteriqi, Kënga dhe pushka, 389). Nuk e di, kjo s'më ka shkuar ndër mend. (Dh. Xhuvani, Përsëri në këmbë, 144).

2) Disa folje, që emërtojnë veprime, sidomos veprime fizike-fiziologjike, përdoren rëndom, sidomos në fjalitë pyetëse, pa pjesëzën *po*, edhe kur është fjala për veprime të veçuara. Kjo ndodh, për arsye se me anë të fjalive të tilla pyesim zakonisht për veprime të veçuara. Megjithatë, kur duam të përcaktojmë më mirë kuptimin kohor të së tashmes, mund ta përdorim fare natyrshëm pjesëzën *po*. P.sh.

— Pse *hesht*, Tit? Të paktën ti mos hesht. Ç'mendon ti? S'mund të bëj unë një punë? (Dh. Xhuvani, Përsëri në këmbë, 144).

— *Po habitesh?* — tha kryeveqilharxhi...

— ... Ti nuk më *dëgjon*? Ti *po qan*?... (I. Kadare, Kështjella, 109, 123).

*

Kur përdoret me kuptim kohor të pacaktuar, folja në kohën e tashme nuk shoqërohet me pjesëzën *po*. E përdorur kështu, ajo mund të tregojë:

1) Veprime që përsëriten herë pas here. P.sh. Janë çelur udhë, udhë të gjëra, kryq e tërthorë. Traktorët *tërheqin* rrëshqanë trungjet dhe atje, në të përpjetë, trungjet *vërsulen* teposhtë, të llahtarshëm, nëpër lugjet e drunjtja, dhe me potere të hatashme *bien* tutje në fund të pyllit, ku i *pret* sharra. Sharrat elektrike të dorës *utërijnë* nga të katër anët e pyllit (Dh. Shuteriqi, Kënga dhe pushka, 347).

2) Veprime të zakonshme që nuk lidhen me një kohë të caktuar, sepse kanë vlerë gjithëkohore. Një përdorim i tillë i së tashmes vihet re sidomos në fjalët e urta popullore (proverbat) dhe në tekstet shkencore, ku bëhen pohime, që kanë vlerë për çdo kohë, pra, edhe për çastin e ligjëritimit. P.sh.

Ai që *s'punon*, *lëngon*. *Gjykon* puna, *s'gjykon* guna. Ujët që *rri* më një vend, *qelbet*. Lumi *fle*, hasmi *s'fle*. (Fjalë të urta të popullit tonë, 28, 30, 42, 78).

Oksidi i karbonit *është* një gaz pa ngjyrë, pa erë, pak më i lehtë se ajri, nuk *tretet* në ujë. Oksidi i karbonit *është* shumë i helmët.

Oksidi i karbonit *formohet*, kur qymyri *digjet* në temperaturë të lartë dhe kur oksigjeni nuk *është* i mjaftueshëm për të oksiduar të gjithë karbonin e qymyrit në gaz karbonik (nga libri «Kimia» për kl. VIII — 1968, f. 98).

*

E tashmja e mënyrës dëftore mund të përdoret edhe me kuptimin e së ardhmes, kur në fjali ka tregues kohorë, qëshenjojnë të ardhmen, si *nesër*, *pasnesër*, *pas një ore* etj. Në këtë përdorim folja në kohën e tashme nuk shoqërohet me pjesëzën *po*, megjithëse shenjon veprime të veçuara. P.sh.

— Dëgjo, e bekuar, *nesër* të *vjen* mishi te dera, *po shih* e dil vetë se... (J. Xoxa, Novela, 68).

*

Me kuptimin e së shkuarës koha e tashme e mënyrës dëftore përdoret në këto dy raste.

1) Kur duam që një veprim a ngjarje, që ka marrë fund në të shkuarën, ta paraqitim sa më të gjallë, sikur të ndodhte përpara syvet tanë. Në këtë rast ajo quhet e tashme historike, sepse përdoret me vlerën e së shkuarës. P.sh.

Krujë, o qytet i bekuar,
Prite, prite Skënderbenë,
Po vjen si pëllumb i shkruar,
të shpëtojë mëmëdhenë.

(N. Frashëri, Hist. Skënderbeut).

Jemi në Labovën e Poshtme afër darkës së 19 janarit 1944. *Vjen* një fonogram që thotë: «Komandanti i Brigadës të niset urgjentisht për Sheper». E dërgon Shtabi i përgjithshëm. *Nisemi* menjëherë lart malit. Nata na zë në malin e Labovës. Mezi kalojmë Çajupin dhe mëngjezi na zë në kishën e Sheperit, në Zagori... (M. Shehu, Kujtime nga jeta e Brigadës I Sulmuese, 10,11).

2) Kur folja tregon një veprim që ka nisur në të shkuarën dhe vazhdon edhe në çastin e ligjërimit. Në këtë rast e tashmja, e përdorur me vlerën e kohës së kryer (shih § 5), plotësohet nga një tregues kohor, që tregon cakun e fillimit të veprimit të emërtuar nga folja. Në këtë përdorim folja në kohën e tashme zakonisht nuk shoqërohet me pjesëzën *po*. P.sh.

— Kemi tri net që po thua nuk *flemë* [= kemi fjetur]. (I. Kadare, Kështjella, 23). ... Ja se ç'ma *ha* e ç'ma *bren* zemrën këto tre vjet, që kur u bënë fejesat tona... (Dh. Shuteriqi, Kënga dhe pushka, 56).

Shënim. — Veta e parë shumës e kohës së tashmes të dëftores përdoret edhe me vlerën e mënyrës urdhërore për të shprehur një këshillë, nxitje etj. të folësit. P.sh.

— *Dalim* në ajër të pastër — tha kryeveqilharxhi.

— *Shkojmë* në çadrën time të pimë ndonjë gjë dhe të çlodhemi pak... (I. Kadare, Kështjella, 28, 17-18).

§ 2. Koha e shkuar

Nga pesë nëndarjet kryesore të kohës së shkuar, e pakryera, e kryera e thjeshtë dhe e kryera zakonisht tregojnë veprime të përfunduara para çastit të ligjërimit. Kurse më se e kryera dhe e kryera e tejkshuar tregojnë veprime të përfunduara para një çasti të caktuar të së shkuarës. Këto formime kohore dallohen midis tyre edhe nga nuancat aspektore, për të cilat do të bëhet fjalë në paragrafët përkatës.

§ 3. E pakryera

Kuptimi themelor i së pakryerës është të tregojë vazhdimin e një veprimi në një çast të caktuar të së shkuarës. Por ajo përdoret edhe me kuptime të tjera, për të cilat do të bëhet fjalë më poshtë. Në

lidhje me çastin e ligjërimin, veprimi i shprehur nga folja në të pakryerën është përfunduar, por kjo gjë kuptohet vetëm nga konteksti, sepse vetë folja në këtë rast nuk tregon gjë as për mbarimin as për fillimin e veprimit të emërtuar prej saj.

Kur përdoren në kuptimin themelor të së pakryerës, foljet (me disa përjashtime për të cilat shih § 1, shënimet 1,2), shoqërohen zakonisht me pjesëzën *po*. Kjo i jep mundësi foljes në të pakryerën të tregojë një veprim të veçuar, që vazhdonte ende në një çast të caktuar të së shkuarës, i cili shenjohej zakonisht me anë të një treguesi kohor (plotës kohe ose fjali e varur kohore).

Po me këtë kuptim mund të përdoret edhe forma perifrastike e ndërtuar me anë të së pakryerës së foljes ndihmëse *jam* dhe përcjellores së foljes themelore. P.sh.

Kështu mendonte Dini pa vënë re se *po rëndonte* me bërryl mbi dcrëzën e derës së vagonit, ku qe pështetur. Treni *po hynte* në kthesën e madhe (Dh. Xhuvani, Përsëri në këmbë, 6).

Kur s'arrinte të kapte telin me duar, e zinte me dhëmbë dhe e shtrëngonte me një pasion të tillë, sa të vinte mendja se *ishte duke shqyer* armikun e tij më të tmerrshëm. (N. Prifti, Çezma e floririt, 123).

Një mëngjes heret, kur *ishte duke ecur* poshtë e përpjetë oborrit, që nga hajati i shtëpisë deri te avllia, Dini qëndroi e mbajti vesh. (Dh. Xhuvani, Përsëri në këmbë, 120-121).

Shënim. — Përdorimi i pjesëzës *po* në kohën e pakryer nuk është aq i domosdoshëm sa në kohën e tashme. P.sh.

Tani ato me siguri *flinin*, të lodhura e të këputura nga rruga, në çadrën e tyre ngjyrë lila ... me hapa të qeta ai u kthye edhe u fut në çadër, pa iu hedhur as sytë dy rojeve, që *rrinin* si të ngrirë me heshta në duar, në hyrje të saj. Pastaj ngriti sytë nga adjutanti që *priste* në këmbë. Mbi çadër shiu *bënte* një zhurmë të butë. (I. Kadare Kështjella, 9,9, 10,12).

*

E pakryera e dëftores përdoret, ndër të tjera, edhe me këto kuptime:

1) Për të treguar një veprim, që është përsëritur herë pas here në të shkuarën. Kuptimi i përsëritjes del nga konteksti. Në raste të tilla folja në të pakryerën plotësohet shpesh nga tregues kohorë, që e bëjnë të qartë përsëritjen e veprimit. Këta tregues kohorë mund të jenë: a) një plotës kohe që tregon një fraksion a periudhë kohe, që përsëritet, si *çdo mëngjes, çdo ditë, çdo javë, çdo vit, herë pas here* etj.; b) një fjali e varur, kryesisht, kohore (por edhe vendore, shkakore etj.), që ka si kallëzues një folje *po* në të pakryerën e dëftores. Në këtë rast si në fjalinë kryesore ashtu edhe në të varurën e pakryera nuk shoqërohet me pjesëzën *po*. P.sh.

a) Jeniçerët i *ndërrojnë* çdo dy orë me trupa të freskëta. (I. Kadare, Kështjella, 116). Herë pas here *kthente* kokën e *shikonte* fytyrën e të vëllait dhe sytë i *ndalte* në atë të gërvishturën e faqes. (D. Agolli, Komisari Memo, 8). Nganjëherë në vendet më të ngushta të saj, trupat *bllokoheshin*, gjersa xhenierët *hapnin* ndonjë shteg ndihmës për të përballuar dyndjen e paprerë. Pastaj rruga *liruhej* përsëri dhe ushtria *lëvizte* ngadalë përmes pluhurit (I. Kadare, Kështjella, 8).

b) Kur i vinin bashkëfshatarët në qytet dhe *shtronte* bisedë me ta, çdo bisedë *mbaronte* thujse njëloj... (S.Th. Andoni, I dërguar nga klasa, 20). Ata heshtën. Sa herë që *bisedonin* për protezat, midis tyre *binte* një heshtje e rëndë. (Dh. Xhuvani, Përsëri në këmbë, 12). Shpeshherë ato *hidheshin* nga shkëmbinjtë dhe *copëtoheshin* nëpër humnerë, kur ushtarët *iu afroheshin* për t'i kapur. (I. Kadare, Kështjella, 9).

2) Për të treguar një veprim që ka zgjatur për një kohë pak a shumë të gjatë në të shkuarën. Edhe në këtë rast e pakryera nuk shqërohet me pjesëzën *po*. P.sh.

Në fushat e bregdetit dhe në krahinat e tjera pjellore të Ilirisë popullsia *merrej* me bujqësi e blegtori dhe me kulturat frutore. Në krahinat e brendshme malore ekonomia e tyre *mbështetej* kryesisht në blegtorinë...

Veglat, me të cilat *punohej* toka, ishin parmenda e drunjtë dhe kazma e hekurt... (Historia e Shqipërisë, Tiranë, 1959, I/53,54).

3) E pakryera e dëftores përdoret edhe si e tashme në të shkuarën. Në këtë rast ajo shenjon një veprim, që në një çast të dhënë të së shkuarës është shprehur me kohën e tashme. Kjo ndodh atëhere kur një fjali të ligjëratës së drejtë me foljen kallëzues në të tashmen e dëftores e kthejmë në një ligjëratë të zhdrejtë duke e shndërruar kështu në një fjali të varur nga folje të tilla si *them*, *pyes*, *përgjigjem* etj. në një nga kohët e së shkuarës, kryesisht në të kryerën e thjeshtë ose në të pakryerën. Një zëvendësim i tillë i së tashmes me të pakryerën mund të ndodhë edhe atëhere kur fjalitë, me të cilat përshkruhet një peisazh, kthehen në fjali të varura nga një fjali tjetër, ku folja është në një nga kohët e së shkuarës. Në këtë rast e pakryera e ruan pjesëzën *po*, në rast se e ka pasur koha e tashme e ligjëratës së drejtë. P.sh.

Kronikani shkruante se këto ishin male të larta, ku as serrat nuk *fluturonin* dot... Pashai i tha se nuk *donte* të hante. (I. Kadare, Kështjella, 7, 11). As Adili s'po ngopej dot atë mëngjez së shikuari këtë fushë të gjerë, që *shtrihej* lirisht në mes dy lumenjve të mëdhenj, Vjosës dhe Semanit, e *mbyllej* përpara... nga një vetull e dëndur dhe e errët pishash... (J. Xoxa, Lumi i vdekur, I/74).

Shënime:

1) E pakryera e foljevet *jam* dhe *kam* përdoret jo rrallë edhe me kuptimin e së kryerës së thjeshtë (shih sqarimet përkatëse në § 4).

2) Nëpër proverba e aty-këtu edhe në gjuhën letrare e pakryera e dëftores përdoret jo rrallë edhe me vlerën e mënyrës kushtore nëpër apodosa periudhash hipotetike. P.sh.

Të mos kisha ata kalamaj, që po më hanë sytë, *shkoja* [= do të shkoja] e *luftoja* [= do të luftoja] me Hekuranin. Atë, fjala vjen, nuk do ta kishte çikur as me majën e thoit xhandari, se *ndareshin* [do të ndareshin] keq. (Dh. Shuteriqi, Kënga dhe pushka, 124, 119-120).

§ 4. E kryera e thjeshtë

Kuptimi themelor i së kryerës së thjeshtë është të tregojë përfundimin e një veprimi në një çast të caktuar të së shkuarës. Pra, ndryshimi i kësaj kohe nga e pakryera ka më fort karakter aspektor.

E pakryera zakonisht e paraqit veprimin në zhvillim e sipër në një çast të caktuar të së shkuarës, kurse e kryera e thjeshtë zakonisht e paraqit veprimin të përfunduar në një çast të caktuar të së shkuarës. P.sh.

Kamioni e *la* pas bërrylin e rrugës dhe *u ndal* atje ku kodra *shtrinte* gjunjët e saj në luginë. Të parët *zbritën* shoferi dhe një grua me një fëmijë nja shtatë a tetëvjeçar. Gjashtë burra *qëndronin* ende në karroceri dhe *flisnin* me njëri-tjetrin me zë të lartë. (D. Agolli, Komisari Memo, 3).

Por e kryera e thjeshtë në gjuhën shqipe, ashtu si koha e tashme (shih § 1), përdoret edhe me një kuptim kohor të pacaktuar e në disa rrethana edhe me kuptimin e së ardhmes. Gjithashtu ka raste që e kryera e thjeshtë përdoret edhe me kuptimin e së kryerës.

Folja e përdorur në kuptimin themelor të së kryerës së thjeshtë tregon një veprim të përfunduar në një të shkuar të largët e të afërt. Në këtë rast ajo zakonisht shoqërohet me tregues kohorë, që shënojnë një kohë të caktuar të së shkuarës dhe që përjashtojnë kështu çastin e ligjërit. Të tillë tregues kohorë janë p.sh. ndajfoljet e kohës *dje, pardje, vjet, parvjet, atëhere* etj., ose togfjalëshat me kuptim kohor të tipit *atë ditë, atë vit, para dy ditësh, para një jave* etj. P.sh.

— Po, — *tha* me mundim Dini. — *Erdhi*, më *pa, qau* dhe *iku*. Më *pa*, siç po më sheh ti. (Dh. Xhuvani, Përsëri në këmbë, 81).

Në të dalë të dimrit, kur delegatët e sulltanit *u larguan*, ne e *kuptuam* që lufta ishte e pashmangshme. Ata na *bënë* gjithfarë presionesh që ne të prananim vasalitetin. (I. Kadare, Kështjella, 3).

Shënime:

1) Kur duam të vëmë në dukje se veprimi i përfunduar në të shkuarën ka zgjatur një farë kohe, atëhere e shoqërojmë foljen me tregues kohorë të tillë si *kurrë, tërë jetën* etj., ose e përsëritim atë. P.sh.

... Ç'thua, mor derëzi? Mos u preve në atë shtëpi ti, që të grisesh aty? Po të *mori* shpirtin *tërë jetën*, bre. Ikë, shko te jot mbesë, Uan. (Dh. Shuteriqi, Kënga dhe pushka, 212).

Po *theri* e *theri* sulltan qeni me dorë të xhelatëve të tij... Atë ditë xha Demi *u hëngër* e *u ther* me vetëveten me shumë se ç'e kish bërë të tjera herë. (Dh. Shuteriqi, Kënga dhe pushka, 74,129).

2) Me tregues kohorë të tipit *sot, sivjet, këtë javë* etj., që përfshijnë edhe çastin e ligjërit, e kryera e thjeshtë mund të përdoret atëhere kur folësi vë në dukje vetëm përfundimin e veprimit, pa e lidhur këtë me çastin e ligjërit. P.sh.

Moj, nuse, a *zure* kos sot ti, siç të porosita...? (J. Xoxa, Lumi i vdekur, I/253) — U po si ma gjete derën, moj Vasili? Ç'qe kjo erë që të *ndolli* sot? (J. Xoxa, Novela, 69).

*

Me kuptim kohor të pacaktuar e kryera e thjeshtë përdoret, për të shprehur mendime me vlerë të ngahershme. Një përdorim i tillë ndeshet nëpër fjalë të urta popullore. Në këtë rast zhduket dallimi kuptimor midis së kryerës së thjeshtë dhe së tashmes me kuptim kohor të pacaktuar (shih § 1) dhe, si rrjedhim, ato mund të zëvendësojnë njëra-tjetrën. P.sh.

Kush mëngoi, bloi. Nuk u lodhe sot, do [të] mundohesh mot. Punove? gëzove. Hëngre fikun, vish leshnikun. (Fjalë të urta të popullit tonë, 33, 36, 40, 55).

*

Me kuptimin e së ardhmes e kryera e thjeshtë përdoret:

1) Kur folësi një veprim a) që s'ka nisur ende ose b) që është në zhvillim e sipër, e quan dhe e paraqit si një fakt, që do të vërtetohet së shpejti, pra, si një fakt të kryer. P.sh.

«Largohu, se t'i hodha zorrët në majë të plepit», më thotë i pa-turpshmi. (D. Agolli, Komisari Memo, 33).

Herë-herë shoferi e ngadalësonte shpejtësinë dhe bërtiste me të madhe: «Hapuni, se ju shtypa!» (Dh. Xhuvani, Përsëri në këmbë, 191-2).

— *Erdha!* — thirri Batua dhe vrapoi me shishe në dorë. (D. Agolli, Komisari Memo, 114).

— *Ika*, — tha mjeku dhe u ngrit — mund të vij prapë.

— ... Do të vij, — premtoi Titi, — sa të mbaroj punë, *erdha*. (Dh. Xhuvani, Përsëri në këmbë, 119, 167).

2) Në fjali të varura kushtore të ndërtuara me lidhëzën nënrenditëse *po*. Në këtë përdorim ajo është sinonime me të tashmen e lidhëzës. Në raste të tilla në fjalinë drejtuese folja është në të tashmen e urdhërores a të dëftores ose në të ardhmen e dëftores, por mund të jetë edhe në të kryerën e thjeshtë të përdorur me kuptimin e së ardhmes P.sh.

— *Po s'erdhe* ti, as ne s'vemi — thanë shokët e tjerë. (Dh. Xhuvani, Përsëri në këmbë, 231).

... Dhe mos kujto se ne do të të lutemi: «Aman, o Qano, bëju [= bëhu] përgjegjës këshilli, se, *po s'u bëre*, na mori lumi!» (D. Agolli, Komisari Memo, 13).

Të kryerën e thjeshtë e gjejmë të përdorur edhe me kuptimin e kohës së kryer. P.sh.

— *Erdha* [= kam ardhur] të punoj këtu në Maliq. Më *thanë* [= kanë thënë] se kini kërkuar një mësonjës. (F. Gjata, Këneta, 230).

— *Erdha* [= kam ardhur] për një punë të ngutshme — tha mjeku.

— Kjo është përpjekja jonë e fundit, Mevla Çelebi, — tha kryeveqilharxhi. — Ne *bëmë* [= kemi bërë] çmos, por fati gjer tani s'na *buzëqeshi* [= ka buzëqeshur]. Kjo është përpjekja e fundit. (I. Kadare, Kështjella, 97, 207).

Shënime:

1) Për përdorimin e së kryerës së thjeshtë në vend të së kryerës së tejshtuar në fjalitë e varura kohore, të lidhura me anë të lidhëzave nënrenditëse *si*, *pasi*, shih § 7.

2) Në vend të së kryerës së thjeshtë të foljevet *jam* dhe *kam* përdoret aty-këtu e pakryera e tyre. Kjo dukuri do shpjeguar më fort me faktin se këto dy folje tregojnë një gjendje që e karakterizon kryefjalën për një kohë të gjatë. E me që e kryera e thjeshtë, si rregull, vë në dukje vetëm përfundimin e një veprimi a të një gjendjeje, *po* jo të zgjaturit e tij, ajo ka prirje të zëvendësohet nga e pakryera. Por jo rrallë vihet re edhe dukuria e kundërt, që mund të shpjegohet

me paqartësinë e ndjenjës gjuhësore në përdorimin e këtyre foljeve në këto dy kohë. P.sh.

a) Jam këtu me inxhinier E.D., i cili ka përvijuar projektimin e parkut të Korçës. *Ishte* [= *qe*] puna e tij e parë, mbasi kreu studimet ...

— *Ishe* [= *qe*] ti kur e çau i Shën Kolli shkëmbin? — pyet një nga punëtorët dhe ne qeshim.

— Nuk *isha* [= *qeshë*] — përgjigjet. — Atë s'e kam parë. Por ty dhe Sabriun, ju pashë... si e mbyllët grykën. (Dh. Shuteriqi, Kënga dhe pushka, 386, 419).

b) Qielli s'shihej fare e më dukej se koha *qe* [= *ishte*] e vrenjtur e binte shi, se fletët shushurinin dhe ajri aty ishte i lagësht. (S. Th. Andoni, I dërguar nga klasa, 136). Shtëpia *qe* [= *ishte*] e vogël, me dy të ndara e një çardhak në mes. Dhoma e zjarrit, ajo ku rrinin dimër e verë, *qe* [= *ishte*] me dysheme... (N. Prifti, Çezma e floririt, 58).

§ 5. E kryera

Kuptimi themelor i së kryerës së mënyrës dëftore është të tregojë përfundimin e një veprimi, që nuk i ka këputur lidhjet me çastin e ligjërimit. Si rrjedhim, nëpërmjet kësaj kohe krahas përfundimit të veprimit folësi vë në dukje edhe pasojat e tij në çastin e ligjërimit. E pikërisht këtu qëndron ndryshimi themelor i kësaj kohe nga e kryera e thjeshtë, nëpërmjet së cilës, siç u theksua në § 4, folësi synon të vërë në dukje vetëm përfundimin e veprimit në një çast të caktuar të së shkuarës. P.sh. të krahasohet përdorimi i këtyre dy kohëve në periudhën e mëposhtme:

... dhe kur hapej muhabeti për gurbetin, xha Telua thoshte:

— Lipsur qoftë, se na *hangri* gjithë djemtë e na *ka djegur* zemrën. (Z. Sako, Medalja e trimërisë).

E kryera e thjeshtë *hangri* tregon se veprimi i «të ngrënit të djemvet» nga kurbeti kish marrë fund në çastin, kur xha Telua i thoshte këto fjalë, kurse e kryera *ka djegur* tregon se njerëzit e kishin zemrën ende të djegur nga pasojat e kurbetit.

Në kuptimin e saj themelor e kryera përdoret:

1) Kur veprimi i përfunduar lidhet me çastin e ligjërimit nëpërmjet pasojavet të tij. Në këtë rast ajo a) mund të mos shoqërohet me asnjë tregues kohor; b) mund të shoqërohet me një tregues kohor, që shenjon një periudhë të caktuar kohe, e cila e përfshin edhe çastin e ligjërimit, si *sot*, *sivjet*, *këto ditë*, *këtë javë*, *këtë muaj*, *këtë vit* etj.; *që dje*, *që vjet*, *që atëherë*, *që atë ditë*, *që atë javë* (e gjer më *sot*) etj., c) mund të shoqërohet me një tregues kohor me kuptim të pacaktuar, si *gjithmonë*, *gjithnjë*, *kurdoherë*, *shpesh*, *dëndur*, *herë pas here*, *kurrë* etj. P.sh.

a) — Ne kemi mbetur edhe pa komisar! — tha Nurka.

— Komandanti Rrapo *ka përzënë* tre komisarë, — tha Memua. Komandanti Rrapo do të përgjigjet për këtë. (D. Agolli, Komisari Memo, 60).

— E di që *ke ardhur* për dinamit. *Isha* në Maliq. (F. Gjata, Kënetë, 383).

— Nga lufta e *kanë pësuar*? — pyeti Vehbiu.

— E kush s'ka pësuar nga lufta? — ia bëri përkthenjësi. (Dh. Shuteriqi, Kënga dhe pushka, 269).

b) — ... Tani unë punoj duke kënduar.

— Ndaj ke nxjerrë shumë qymyr këto ditë... — e ngacmoi xha Jorgji, — duket ke kënduar shumë.

(N. Prifti, Çezma e floririt, 143).

... dhe Arbëri mynxyra mbi mynxyra ka parë këto dhjetë vjet.
(Dh. Shuteriqi, Kënga dhe pushka, 76).

c) E në është kështu, në këta damarë, kurrë gjaku i Shqipërisë sonë nuk ka lëvizur me një gjallëri dhe vrull si ky që kam para syve. (Gj. Zheji, Tregimet e Krudës, 4). Partia jonë e ka patur kurdoherë në qendrën e vëmendjes së saj zhvillimin e shkollës sonë të re. (M. Shehu, Mbi revolucionarizimin e mëtejshëm... 5). — Ej, dëgjoni këtu: Këto janë senetet e kambjalet e dëftesat e borxheve, që kemi paguar denbabaden, janë zgjebja që na ka ngrënë tërë jetën. (S. Spasse, Afërdita përsëri në fshat, 229).

2) Kur veprimi i nisur në të shkuarën vazhdon ende në çastin e ligjërit. Ky kuptim i së kryerës del nga konteksti, ku mund të ketë edhe tregues kohorë, që tregojnë pikënisjen e veprimit ose gjithë kohën që nga fillimi i veprimit e gjer në çastin e ligjërit. Në këtë kuptim mund të përdoret edhe koha e tashme e dëftores (shih § 1). P.sh.

... Duhet ta dish... se ka tre vjet që ma ka molepsur mola shpirtin. Dhe nëpër hangare të mëdha kombajnmat kanë çelur gojën e po gërhasin në vapë. (Dh. Shuteriqi, Kënga dhe pushka, 55, 404).

Në mes tuaj kam qëndruar
e jam duke përvëlur.

(N. Frashëri, Fjalët e qiririt)

*

E kryera e mënyrës dëftore përdoret nganjëherë edhe me kuptimin e së kryerës së thjeshtë dhe të së ardhmes.

Me kuptimin e së kryerës së thjeshtë, dmth. për të treguar vetëm përfundimin e një veprimi, pa vënë në dukje lidhjen e tij me çastin e ligjërit, koha e kryer haset kryesisht në gjuhën e folur, por aty-këtu edhe në gjuhën e shkruar. P.sh.

E di ç'i ka pjellë [= polli] në kohën e Austrisë një ushtari karadaklli, që pati mbetur në fshat nga prishja e Serbisë? ... Ç'të duhet ty sot se ku e kam hedhur [= hodha] unë lumin mahere (J. Xoxa, Lumi i vdekur, III/100; II/129).

I kam prerë edhe udhën pardje e i jam lutur...

Dhe rrallë na kujton Konstandini, siç e di dhe ti vetë, o Nikodim, ndonëse nëna e tij, Maria, ka vdekur me emrin e tij në gojë, dhe babait tonë iu çel për të një plagë. (Dh. Shuteriqi, Kënga dhe pushka, 62, 55).

*

Kurse me kuptimin e së ardhmes e kryera, ashtu si e kryera e thjeshtë, (shih § 4), përdoret atëherë kur folësi e paraqit si një fakt të kryer një veprim, që s'ka nisur ende. P.sh.

Po e gjete librin, që më ka humbur, *ta kam falur* [= do të ta fal].

1) Për sa i takon së kryerës së dytë, kjo ka një kuptim të ngjashëm me atë të së kryerës, veçse përdoret zakonisht për veprime të një të shkuare të largët. P.sh.

Në Elbasan u *kanë pasë thënë* surreta. (Dh. Shuteriqi, Gurnecka, 40).

§ 6. Më se e kryera

Kuptimi themelor i më se të kryerës është të tregojë përfundimin e një veprimi para një çasti të caktuar të së shkuarës. Ky veprim i përfunduar a) mund të lidhet me çastin e caktuar të së shkuarës nëpërmjet pasojave ose duke vazhduar gjer në atë çast, ose b) mund të mos ketë më lidhje me të. P.sh.

a) Vetëm të nesërmen Dini mendoi i qetë për ato që *kishin ndodhur*. Ai filloi të bindej se *ishte kthyer* papritur e pakujtuar në një trung. (Dh. Xhuvani, Përsëri në këmbë, 16).

b) Dini provoi të kujtonte se si dikur *kishte hypur* në një caracë, se ai *ishte varur* te një degë dhe *ishte hedhur* prej saj e *kishte rënë* shëndoshë e mirë në tokë. (Dh. Xhuvani, po aty, 17).

Si në rastin e parë (a) ashtu edhe në rastin e dytë (b), kuptimi i më se të kryerës përcaktohet nga konteksti. Në rastin e parë më se e kryera përdoret si një e kryer e së shkuarës, kurse në rastin e dytë ka vlerën e një të kryere të thjeshtë të së shkuarës. Kjo duket qartë, po të kthejmë në ligjëratë të zhdrejtë nga ligjërata e drejtë fjali, në të cilat foljet janë përdorur një herë në të kryerën dhe një herë në të kryerën e thjeshtë. P.sh.

Pastaj njëri nga adjutantët i solli raportin e komandantit të kampit, që lajmëronte se trupat *kishin arritur* të gjitha sipas parashikimit, se *ishin vënë* roje kudo sipas rregullave, se *ishin nxjerrë* patrulla zbulimi në gjithë zonën dhe se gjithshka tjetër ishte krejt në rregull. (I. Kadare, Kështjella, 10).

Shënim. Po ta kthejmë përmbajtjen e raportit të komandantit të kampit në ligjëratë të drejtë, atëherë të gjitha foljet e nënvizuara do të vihen në kohën e kryer:

«Trupat *kanë arritur* të gjitha sipas parashikimit, *janë vënë* roje kudo sipas rregullave, *janë nxjerrë* patrulla zbulimi në gjithë zonën dhe gjithshka tjetër është krejt në rregull».

*

Miqtë e tij të ngushtë, ata që e *kishin këshilluar* të merrte vajza me vete, i *kishin thënë* se në vendin, ku ai shkonte, ishte vështirë të kapje robina. (I. Kadare, Kështjella, 9).

Shënim. Po ta kthejmë këtë periudhë në ligjëratë të të drejtë, atëherë të gjitha foljet e nënvizuara do të vihen në të kryerën e thjeshtë.

«Mirëpo miqtë e mi të ngushtë, ata që më *këshilluan* të merrja vajza me vete, më *thanë*: «Në vendin, ku po shkon, është vështirë të kapësh robina».

*

Në të dyja këto përdorime më se e kryera mund të shoqërohet me tregues kohorë të caktuar, që shprehen me anë të një plotësi kohe (si p. sh. *që atë ditë, në atë kohë, atë vit, gjer atëhere* etj.) ose me anë të një fjalie të varur kohore (të ndërtuar zakonisht me anë të lidhës nënrenditëse *para se*). Por treguesi kohor mund të nënkuptohet nga sa është thënë më parë e atëhere mund të mos shprehet më.

P.sh.

Gjer atëhere unë *kisha qarë* vetë, *kisha parë* të qanin edhe mo-shatarët e mi, por s'e dija, s'ma merrte mendja se mund të qajnë burrat... Mersin Demirazi ishte djalë i kësaj shtëpie; që 15 vjeç *kish mbetur* pa nënë e pa babë e *kish marrë* udhët. (S. Th. Andoni, i dërguar nga klasa, 128-9, 19). Kronikanin porsa e *kish zënë* gjumi kur u zgjua nga britmat e para të alarmit. (I. Kadare, Kështjella, 171).

Shënime:

1) Më se e kryera përdoret aty-këtu, sidomos në gjuhën e folur, edhe me vlerën e së kryerës së mënyrës kushtore nëpër apodosa periudhash hipotetike. P. sh.

—Të mos të të kisha në vatër time, të *kisha vrarë!*

[= *do të të kisha vrarë*] (Dh. Shuteriqi, Kënga dhe pushka, 137).

2) Më se e kryera e dytë haset më fort nëpër të folmet e Shqipërisë Veriore, kurse në shqipen letrare ndeshet tepër rrallë. Ajo përdoret për të treguar përfundimin e një veprimi para një kohe shumë të largët të së shkuarës. P. sh.

Është e vetmja brengë që më mbetet —shqiptoi më qartë ai, pasi *kish folë* një copë herë, në mënyrë të ngatërruar, për një vajzë të bukur dhe inteligjente, me të cilën e *kishin pasur fejuar* prindët qysh në fëmijëri. (Sh. Musaraj, Para agimit, I/411).

§ 7. E kryera e tejshkuar

Kuptimi themelor i së kryerës së tejshkuar është të tregojë përfundimin e një veprimi para një çasti të caktuar të së shkuarës. Në këtë kuptim, siç shihet, ajo është sinonime me më se të kryerën (shih § 37, pika b). P. sh.

— Zequa u vra! — thirri Hodo Allamani...

— Jo, more! — bëri komandanti Rrapo dhe psherëtiu ngadalë... Fli, o Zeqo vëllai, fli. Kurrë s'të *pat pushuar* mitralozi ty, o Zeqo vëllai! (D. Agolli, Komisari Memo, 178). — Është dragua, — *patën folur* disa. Nga ata që lindin me fletë dhe ngrihen natën vjedhurazi e luftojnë me kuçedrën. Po, ra kështjella e kështjellave, që kurrë s'e *pat shkelur* këmbë armiku. (Dh. Shuteriqi, Kënga dhe pushka, 106, 73).

Nga këto dy forma gramatikore sinonime, në shqipen e sotme letrare përdoret shumë më dendur më se e kryera, kurse e kryera e tejshkuar haset më rrallë. Kjo dukuri do lidhur edhe me dukurinë e zëvendësimit të së kryerës së thjeshtë të foljevet *jam* e *kam* nga forma e së pakryerës. Por aty-këtu haset edhe dukuria e kundërt. P. sh.

a) Andrea Borova shikonte punën e vet, atë punë për të cilën ishte lodhur e shqetësuar muaj të tërë. Në fillim *pat marrë* një tog

me baltë, pastaj e *kish hedhur* [= pat hedhur] atë mbi një skelet të hekurt. (D. Agolli, Komisari Memo, 81).

Që ditën që *kish dalë* [= pat dalë] në gjyq, ai u ndruhej takimeve me Sulltan Rrodhen. (F. Gjata, Përmbysja 35).

b) Ishte një ditë e diel. Rrojtoria e Bexhetit *qe* [= ishte] *mbushur* plot e përplot me njerëz. E ngashërimi im ishte aqë i madh sa fytyra më *qe* [= ish] *ngurosur* e gjendja ime shpirtërore prej kalamanit e kish kaluar atë cakun e njohur të tronditjes, kur lotët nuk dalin më. (S. Th. Andoni, I dërguar nga klasa, 96, 129).

Shënim. — Në fjalitë e varura kohore, të ndërtuara me anë të lidhëzës nënrenditëse *si* (a *pasi*), në vend të së kryerës së tejshkuar mund të përdoret edhe e kryera e thjeshtë (shih § 4). P.sh.

Si *iku* kamarieri, të dy shokët vazhduan për një kohë të gjatë të qeshnin me njëri-tjetrin. (Dh. Xhuvani, Përsëri në këmbë, 129).

*

Në shqipen e sotme e kryera e tejshkuar përdoret, ndonëse rrallë, edhe me kuptimin e së kryerës së lidhës, dmth. për të shprehur një veprim, që *mund* të jetë përfunduar para çastit të ligjërimit. Me këtë kuptim ajo haset nëpër fjali të varura kushtore, të ndërtuara me anë të lidhëzës nënrenditëse *po* (krahaso edhe përdorimin e së kryerës së thjeshtë në një ndërtim të tillë, § 4). P.sh.

Veç harram e paç gjirin, që të kam dhënë, *po u pate rrëfyer* ti. (V. Vinçani, Të rinjtë, 54).

KOHA E ARDHME

§ 8. E ardhmja

Kuptimi themelor i së ardhmes është të tregojë se një veprim pritet të kryhet pas çastit të ligjërimit. Me këtë kuptim përdoret kryesisht e ardhmja e tipit *do të bëj*. P.sh.

Unë ndjej kënaqësinë e rrallë që ta has këtu, majë shkëmbit, tek vërtit në kokë projektidenë, duke soditur gërxhet e greminat, ku *do të ngjiten* xhade të tjera, *do të çilen* të tjera galeri, *do të hidhen* në erë shkëmbenjtë. (Dh. Shuteriqi, Kënga dhe pushka, 384).

Me të njëjtin kuptim, ndonëse më rrallë, përdoret edhe e ardhmja e tipit *kam për të bërë*, por kjo në disa raste e ruan në një farë mase nuancën e detyrimit të togfjalëshit të lirë, nga është formuar. Në rastin e parë ajo është e barazvlershme me të ardhmen e tipit *do të bëj*, kurse në rastin e dytë është vetëm sinonime me të. P.sh.:

a) *Po të më dilni kra*, *kini për të parë* (S.Th. Andoni, I dërguar nga klasa, 12).

«Do të rri shtrirë në diell gjithë ditën, do të çlodhem e rrobat *kanë për t'u tharë*. Shokët *kanë për të më kërkuar*. Me siguri do t'u shkojë mendja se jam në lumë. (Dh. Xhuvani, Përsëri në këmbë, 6).

b) Sa për vete unë do të kthehem në shtëpi; më presin në Labëri.

— Por një ditë *ke për të dalë* nga shtëpia, apo jo? (S. Th. Andoni, I dërguar nga klasa, 177).

Shënime:

1) E ardhmja, në vetën e dytë e të tretë, përdoret nganjëherë edhe në kuptimin e urdhërues, për të dhënë urdhëra nganjëherë, më kategorike se vetë mënyra urdhëruese. P.sh.

— Këmbës t'i bijesh tashti, atë do të marrësh, se ai qe kësмети yt. (N. Prifti, Çezma e floririt, 78).

— Nejse, edhe sikur të mos kthehet Guri, ti do të shkosh vetë në Korçë, Demkë! — iu drejtua mësuesi Demkës. (D. Agolli, Komisari Memo, 58).

2) E ardhmja e tipit *do të bëj* e foljevet *kam*, *jam* dhe *di* (në vetën e dytë e të tretë) përdoret nganjëherë edhe me kuptimin e kohës së tashme me nuancën modale të mundësisë (gjasë a probabilitet). P.sh.

— Jo, usta Osman, vetëm ndonjë damar shtufi *do [të] ketë*, duhet kalitur ca thellë, sa t'i hiqet ai damari. (S. Th. Andoni, I dërguar nga klasa, 23). — *Do [të] jetë* ndonjë djalosh me vullnet... (S. Th. Andoni, po aty, 43).

... Apo mos kushedi ka zemër të mirë? E ç'zemër *do të ketë* ai, moj e mjerë! (N. Prifti, Çezma e floririt, 79).

Memua dhe Xhemali shikuan njëri-tjetrin. «Ky *do të jetë* «Rrapua», menduan dhe e lanë trungun e lisit. — Kushedi se ç'*do të kesh*, se dhëmbi pas heqjes s'duhej të të dhëmbte — tha Rrapua. (D. Agolli, Komisari Memo, 162, 228).

§ 9. E ardhmja e përparme

Forma e tipit *do të kem bërë* në gjuhën shqipe përdoret shumë rrallë në kuptimin e së ardhmes së përparme, dmth. për të treguar një veprim, që pritet të kryhet në të ardhmen para një veprimi tjetër. P.sh.

— Ata do të pendohen për këtë sherr të madh që nisën me ne, atëhere do të jetë vonë — tha kronikani. — Shumë gjak *do të jetë derdhur* ... — Këtu — kryeveqilharxhi, tregoi me dorë token — ata do të shikojnë gjurmët e kampit tonë, që shirat e dimrit *do t'i kenë prishur e mbuluar* me baltë, por që nuk *do t'i kenë zhdukur* dot krejtësisht. (I. Kadare, Kështjella, 111, 208). Nuk ia kam thënë Halilit se sa më është dhëmbur Shkëmbi i Pishkashit, Trueza e Skënderbeut që ai nisi të hedhë në erë sot e dy vjet dhe që, për pak kohë, do të jetë një rënojë, prej së cilës *do të kenë nxjerrë* mijëra dhe mijëra tonelata mineral të kuq. (Dh. Shuteriqi, Kënga dhe pushka, 384).

Kjo formë përdoret më fort për të shprehur veprime të mundshme të së shkuarës. Në këtë përdorim ajo është e barazvlershme me të kryerën e mënyrës lidhore, të prirë nga folja me vlerë modale *mund*. P.sh.

«Kushedi se nga bredhin maleve! — mendoi — *Do të më ketë harruar* fare; dhjetë dit kaluan, ose *mund ta kenë zënë* përsëri karabinierët... (P. Marko, Stina e armëve, 51). «Me siguri», mendoi Memua, «*do ta ketë marrë* vesh opinionin tonë për Spiron. Edhe fjalët e rënda që thashë unë për të fejuarin e saj, *do ta kenë dëshpëruar*» (D. Agolli, Komisari Memo, 111).

§ 10. *E ardhmja në të shkuarën*

Kuptimi themelor i së ardhmes në të shkuarën është të tregojë një veprim, që pritej të kryhej pas një çasti të caktuar të së shkuarës. Me këtë kuptim ajo përdoret për të zëvendësuar kohën e ardhme të ligjëratës së drejtë, në rast se në çastin e kthimit të saj në ligjëratë të zhdrejtë veprimi i emërtuar nga folja nuk është më një veprim, që pritet të kryhet në të ardhmen. P.sh.:

Dulla i tha se atë ditë *do të punonin* me orë [= orar] të zgjatura, ndaj ata nuk *do të bënin* gabim, po të kalonin në ndonjë tavolinë tjetër. (Dh. Xhuvani, Përsëri në këmbë, 208).

Dhe... thanë se dimri dështoi shtatanik me atë fytyrën e tij të ftohtë para kohe e se dimër të prapë *s'kishin për të hequr* atë mot as ata as bagëtia. (J. Xoxa, Lumi i vdekur, I/193).

Por, kur veprimi i emërtuar nga koha e ardhme e ligjëratës së drejtë është një veprim, që pritet të kryhet pas çastit të kthimit të saj në ligjëratë të zhdrejtë, atëhere koha e foljes mbetet e pandryshuar. P.sh.

Kryetari... më tregon se së shpejti *do të përfundojnë* së ndër-tuari godinat e mëdha, që po ngrihen në rrugën e Skelës dhe në rrugë të tjera. Përndryshe, ku *do të futen* ata mijëra mysafirë që *do të presë* Vlora për festë? (Dh. Shuteriqi, Kënga dhe pushka, 403).

*

E ardhmja në të shkuarën përdoret edhe në fjali të varura, kryesisht kundrinore, kur në fjalinë drejtuese kallëzuesi është një folje, që tregon të *menduar* a të *pandehur* (si *mendoj*, *kujtoj*, *pandeh*, *shpresoj* etj.) në të kryerën e thjeshtë ose në të pakryerën. P.sh.

Nga ana tjetër, shpresoi se gjithë kujdesi i tepruar që tregonte nëna për vëllanë e madh, tani *do të binte* mbi këtë. Dhe, sa herë që mundohej të përfytyronte atë «burrin», me të cilin pas disa muajve *do të martohej*, përpara syve të mendjes, atje pranë tij, i dilte edhe Raifi... (M. Prifti, Çezma e floririt, 129, 71).

Shënim. —

Po në ato rrethana, në të cilat e ardhmja zëvendësohet nga e ardhmja në të shkuarën, edhe forma e tipit *do të kem bërë* zëvendësohet nga forma e tipit *do të kisha bërë*, e cila në këtë rast shërben kryesisht për të shprehur një veprim, që mund të jetë kryer para një çasti të caktuar të së shkuarës. Por do pasur parasysh se kjo formë foljore me këtë kuptim përdoret më rrallë. P.sh.

Ata e kishin parë tek ikte kaluar me të jëmën [= me t'ëmën] prapa dhe e muarën me mend se këtij njeriu diç *do t'i kish ngjarë*. Vishej trashë dhe kaq keq i rrinin rrobat në trup, sa menjëherë formoje bindje se këto rroba dikush *do t'ia kish falur* për lëmshë. (N. Prifti, Çezma e floririt, 55, 128).

Bibliografia

- AGALLIU FATMIR Vëzhgime mbi kuptimet e disa trajtave kohore. «Studime filologjike» 1968/2.
- CIPO KOSTAQ Gramatika shqipe. Tiranë 1949.
- CIPO KOSTAQ Sintaksa, Tiranë 1952.
- DAUZAT ALBERT Grammaire raisonnée de la langue français, 3 édition, Paris 1947.
- DEMIRAJ SHABAN Morfologjia e gjuhës së sotme shqipe — (dispensë) II, Tiranë 1961.
- DEMIRAJ SHABAN Rreth formavet të kohës së ardhme në gjuhën shqipe, «Studime filologjike» 1970/3.
- DODI ANASTAS Për vlerën e së kryerës së dëftores në gjuhën shqipe, «Studime filologjike» 1968/1.
- DOMI MAHIR Morfologjia historike e shqipes (konspekt leksione). Tiranë 1961.
- FRASHËRI SAMI Shkronjëto e gjuhësë shqip, Bukuresht 1888.
- GABINSKI M. Voznikovenie infinitiva kak vtoričnyj ballkanskij jazykovoju process. Leningrad — 1967.
- GANSHINA M. Vasilevskaya N. English Grammar. Moskow 1958.
- Gramatica limbii romine. I. Bucuresti 1963.
- Grammatika rucckogo jazyka. I. (Botim i Akademisë së Shkencave të Bashkimit Sovjetik), Moskva 1953.
- JESPERSEN OTTO. The Philosophy of Grammar. (Botim i vitit 1958), London.
- KRISTOFORIDHI KONSTANDIN Grammatiki tis alvanikis glossis. Konstandinopoli, 1882.
- MEYER GUSTAV Kurzgefasste albanesische Grammatik. Leipzig 1888.
- MYDERRIZI OSMAN Gramatika e re e shqipes, Tiranë 1944.
- PAUL HERMANN Deutsche Grammatik, 4. Band. 4. Auflage. Halle (Saale) 1958.
- PEKMEZI GJERGJ Grammatik der albanesischen Sprache. Wien. 1908.
- REFEROVSKIIA E.A. VASILIEVA A.K. Essais de grammaire française. I. Moskva — Leningrad 1964.
- STEINBERG N. Grammaire française (bot. III). Moskva — Leningrad 1966.
- WEIGAND GUSTAV Albaneisische Grammatik im sudestgegischen Dialekt. Leipzig 1913.
- XANONI ANTON Gramatika shqyp, Shkodër 1909.

R é s u m é

LES VALEURS PRINCIPALES DES TEMPS DE L'INDICATIF

Dans cet article l'auteur a traité des valeurs principales des temps de l'indicatif en albanais. Il a mis en évidence, entre autres, qu'en albanais:

1) Lorsqu'il s'agit d'une action isolée (all. einzeln), le présent et l'imparfait se font généralement précéder de la particule *po*, qui est plus fréquente avec le présent.

2) Tant le présent que l'imparfait s'emploient souvent à sens temporel indéfini, pour exprimer des actions qui se répètent de temps en temps, ou bien des actions qui ne s'attachent pas à un temps défini.

3) Le présent s'emploie aussi avec le sens du passé et du futur.

4) L'imparfait s'emploie aussi comme un présent dans le passé.

5) Le passé simple s'emploie pour marquer l'achèvement d'une action dans un moment défini du passé. Mais dans certains emplois il a aussi le sens du futur.

6) La différence entre le passé simple et l'imparfait est plutôt une différence d'aspect.

7) La principale valeur du parfait est de marquer l'achèvement d'une action qui n'a pas rompu ses liens avec le présent.

La différence entre le passé simple et le parfait est donc de caractère aspectuel, le premier visant à marquer l'achèvement, tandis que le deuxième mire à souligner le résultat de l'action.

8) Le plus-que-parfait s'emploie aussi bien comme un parfait que comme un passé simple relativement à un moment défini du passé.

Quand au deuxième emploi, le plus-que-parfait est synonyme du passé ultérieur, du type *pata bërë*.

9) L'emploi du plus-que-parfait au lieu du passé ultérieur, du type *pata bërë* et (plus rarement) vice versa est à rattacher au phénomène analogue, qui a lieu entre l'imparfait et le passé simple des verbes auxiliaires *être* et *avoir*.

10) La forme du type *do të kem bërë* s'emploie très rarement comme un *futurum exactum*. Elle s'emploie plutôt comme un *modus praesumptivus* pour marquer une action probable du passé.

11) Le futur dans le passé, qui est synonyme du conditionnel, s'emploie pour marquer une action, qui était attendue avoir lieu après un certain instant du passé.